



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 63

Gusht

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.6, datë 7.1.2009	Për miratimin e kalendarit të vitit 2009, për menaxhimin e shpenzimeve publike..... 3
Vendim i KM nr.13, datë 7.1.2009	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit, në Finlandë, të z.Bujar Nishani..... 6
Vendim i KM nr.22, datë 14.1.2009	Për një shtesë në buxhetin e vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve për kurimin e z.Mevlan Shanaj, në Greqi..... 6
Vendim i KM nr.28, datë 14.1.2009	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.630, datë 21.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për dhënie ndihme financiare familjeve, shtëpitë e të cilave janë shkatërruar tërësisht nga aksidenti teknologjik, i datës 15 mars 2008, në fshatin Gërdec, bashkia Vorë” 7
Vendim i KM nr.39, datë 14.1.2009	Për miratimin e raportit të dytë kombëtar, periodik, në kuadër të konventës “Kundër torturës, trajtimeve apo dënimeve të tjera të egra, çnjerëzore dhe degraduese” 10
Vendim i KM nr.51, datë 21.1.2009	Për lirim dhe emërimin e anëtarit të Këshillit të Statistikave 10
Vendim i KM nr.54, datë 21.1.2009	Për shkarkim dhe emërim në detyrë..... 10
Vendim i KM nr.93, datë 21.1.2009	Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2009..... 11

Vendim i KM nr.113, datë 2.2.2009	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues dhe fillimin e procedurave për dhënien me koncesion të Shërbimit të Regjistrimit të Barrëve Siguruese.....	11
Vendim i KM nr.120, datë 14.1.2009	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.817, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlerës së dëmeve, të shkaktuara në objektet, pronë private, si rrjedhojë e aksidentit teknologjik, të ndodhur në Gërdec, dhe të listave me emrat e individëve dhe personave fizikë dhe juridikë, që do të kompensohen, si rezultat i procesit të vlerësimit dhe të rivlerësimit”.....	12
Vendim i KM nr.130, datë 27.1.2009	Për miratimin e strategjisë kombëtare për dialogun ndërkulturor, në zbatim të planit dyvjeçar të aleancës së qytetërimeve.....	18
Vendim i KM nr.131, datë 21.1.2009	Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve për përfitimin, në formë granti, të asistencës financiare për zonat e thella malore dhe me popullsi të rrallë.....	27
Vendim i KM nr.143, datë 11.2.2009	Për një shtesë në vendimin nr.338, datë 19.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, të ndryshuar.....	28
Vendim i KM nr.153, datë 11.2.2009	Për dhënien në përdorim Qendrës Kombëtare të Licencimit të disa mjediseve në ndërtesën (godinën) e INIMA-s.....	29
Vendim i KM nr.173, datë 19.2.2009	Për miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2009.....	31
Vendim i KM nr.191, datë 19.2.2009	Për dhënien e një fondi financiar komunës Hajmel të qarkut të Shkodrës, për të ndihmuar familjet e dëmtuara, për shkak të përmytjes nga lumi Gjadër.....	31

VENDIM
Nr.6, datë 7.1.2009

PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË VITIT 2009, PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit të vitit 2009, për menaxhimin e shpenzimeve publike, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Integrimit, Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj, të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore, si dhe fondet speciale të tyre për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KALENDARI PER MANAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI PERGJEGJES	VEPRIMI PERKATES
Dhjetor 2008		MF	Pergatit dhe paraqet ne KPS Kalendarin e MSHP
Dhjetor 2008		KPS	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e MSHP
Dhjetor 2008	31	KM	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e MSHP
Dhjetor 2008	28	MF	Perfundojne konsultimet e brendshme mbi Vleresimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Buxhetore (R.V.P.M.B)
Dhjetor 2008	30	MF	Paraqet ne KPS Raportin mbi Vleresimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Buxhetore (R.V.P.M.B)
Janar	6	KPS	Miraton Raportin mbi Vleresimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Buxhetore (R.V.P.M.B)
Janar	7	KM	Miraton R.V.P.M.B
Janar	14	KM	Shqyrton dhe miraton Programin EFP
Shkurt	2	MF	Paraqet ne KPS tavanet e pergatitjes se PBA
Shkurt	6	KPS	Shqyrton dhe miraton tavanet e pergatitjes se PBA
Shkurt	11	KM	Miraton tavanet e pergatitjes se PBA
Shkurt	23	KM	Paraqet per informacion R.V.P.M.B dhe Tavanet ne Kuvend
Shkurt	16	MF	Dergon Udhezimin e Pergatitjes se Buxhetit per njesite e qeverisjes qendrore dhe fondet e tyre speciale.
Shkurt - Prill	17 Shkurt - 30 Prill	Njesite e Qeverisjes Qendrore dhe Fondet Speciale te tyre	Pergatisin kerkesat e tyre buxhetore
Prill	20	MF	Dorezon per miratim ne KPS parashikimin e perditësuar makro
Prill	27	KPS	Miraton parashikimin e perditësuar makro
Prill	29	KM	Miraton parashikimin e perditësuar makro
Maj	1	Njesite e Qeverisjes Qendrore dhe Fondet Speciale te tyre	Paraqesin ne MoF kerkesat e tyre buxhetore
Maj	4 - 16	MF, MIE dhe DEBASKON	Kryen analizat e kerkesave buxhetore
Maj	18 - 29	MF, MIE dhe DEBASKON	Organizon seancat degjimore me institucionet buxhetore
Qershor	1 - 10	MF	Pergatit dokumentin e PBA dhe tavanet e reja te shpenzimeve te PBA
Qershor	11	MF	Paraqet dokumentin e PBA dhe tavanet e reja te shpenzimeve te PBA per shqyrtim dhe miratim ne KPS

Qershor	19	KPS	Miraton dokumentin e PBA dhe tavanet e reja te shpenzimeve te PBA
Qershor	30	KM	Shqyrton dhe miraton me vendim dokumentin e PBA dhe tavanet perfundimtare te PBA
Korrik	1 - 31	KM	I paraqet Kuvendit per informacion dokumentin e rishikuar te PBA
Korrik	10	MF	Leshon Udhezimin Plotesues te Pergatitjes se Buxhetit per njesite e qeverisjes qendrore dhe fondet e tyre speciale.
Korrik - Gusht	13 Korrik - 30 Gusht	Njesite e Qeverisjes Qendrore dhe Fondet Speciale te tyre	Pergatisin kerkesat e rishikuara buxhetore
Gusht	17	MF	Dorezon ne KPS parashikimin e perditesuar makro
Gusht	21	KPS	Miraton parashikimin e perditesuar makro
Gusht	26	KM	Miraton parashikimin e perditesuar makro
Gusht	31	Njesite e Qeverisjes Qendrore dhe Fondet Speciale te tyre	Paraqesin ne MoF kerkesat e rishikuara buxhetore
Shtator	1 - 11	MF, MIE dhe DEBASKON	Kryen analizat e kerkesave te rishikuara buxhetore
Shtator	14 - 30	MF, MIE dhe DEBASKON	Organizon seancat degjimore me institucionet buxhetore
Tetor	5	MF	Paraqet ne KM parashikimin e perditesuar makro
Tetor	9	KPS	Miraton parashikimin e perditesuar makro
Tetor	14	KM	Miraton parashikimin e perditesuar makro
Shtator - Tetor	30 Shtator - 20 Tetor	MF	Pergatit dokumentin e rishikuar te PBA dhe e paraqet per shqyrtim ne KPS
Shtator - Tetor	30 Shtator - 20 Tetor	MF	Pergatit Projektbuxhetin Vjetor dhe e paraqet per shqyrtim ne KPS
Tetor	23	KPS	Miraton Projektbuxhetin Vjetor dhe dokumentin e rishikuar te PBA
Tetor	28	KM	Shqyrton dhe miraton me vendim Projektbuxhetin Vjetor dhe Dokumentin e Rishikuar te PBA
Tetor	30	KM	I paraqet Kuvendit per informacion Projektbuxhetin Vjetor dhe Dokumentin e Rishikuar te PBA

VENDIM
Nr.13, datë 7.1.2009

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2009, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT, NË FINLANDË,
TË Z.BUJAR NISHANI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 12 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi 2 000 000 (dy milionë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit, në Finlandë, të z.Bujar Nishani.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3.Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale.

4.Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.22, datë 14.1.2009

**PËR NJË SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2009, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE PËR KURIMIN
E Z.MEVLAN SHANAJ NË GREQI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi 1 875 000 (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, për përballimin e shpenzimeve për kurimin e z.Mevlan Shanaj, në Greqi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.

4. Vendimi nr.1667, datë 24.12.2008 i Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit, në Greqi, të z.Mevlan Shanaj”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.28, datë 14.1.2009

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.630, DATË 21.5.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE, SHTËPITË E TË CILAVE JANË SHKATËRRUAR TËRËSISHT NGA AKSIDENTI TEKNOLOGJIK, I DATËS 15 MARS 2008, NË FSHATIN GËRDEC, BASHKIA VORË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr.2 të vendimit nr.630, datë 21.5.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Të hiqen emrat e shtetasve që përsëriten, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Të shtohen emrat, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga ky vendim, dhe të diferencës së evidentuar në shumën e dhënë me vendimin nr.630, datë 21.5.2008 të Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e vitit 2009, t’i shtohet fondi 5 027 000 (pesë milionë e njëzet e shtatë mijë) lekë.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i vitit 2009.

4. Ngarkohet bashkia e Vorës të kryejë pagesat për familjarët, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

EMRAT QË PËRSËRITEN NË LIDHJET NR.1 DHE NR.2 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.630, DATË 21.5.2008

Nr.	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	OBJEKTI	ADRESA	SQARIME
1	SADIK	ASLLAN	GJIKOLA	SHTEPI BANIMI	MARQINET 2	Përsëritet 2 here ne VKM 630, lidhja nr. 2 me nr. rendor 46-47
2	SELAMI	SHABAN	SULA	SHTEPI BANIMI	MARQINET 2	Përsëritet 2 here ne VKM 630, lidhja nr. 2, me nr. rendor 54-55
3	SHKELQIM	IBRAHIM	GJIKOLA	SHTEPI BANIMI	MARQINET 2	Përsëritet 2 here ne VKM 630, lidhja nr. 2, me nr. rendor 61-62
4	HAXHI	IBRAHIM	GJIKOLA	SHTEPI BAN IMI	MARQINET 2	Përsëritet 2 here ne VKM 630, lidhja nr. 2, me nr. rendor 126-127
5	KALEM	SEFER	GERDECI	SHTEPI BANIMI	MARQINET 2	Përsëritet 2 here ne VKM 630, lidhja nr. 2, me nr. rendor 137-138
6	HASAN	BEQIR	GERDECI	SHTEPI BANIMI	MARQINET 1	Përsëritet 2 here ne VKM 630, lidhja nr. 2, me nr. rendor 176-177
7	AGIM		ALLA	SHTEPI BANIMI	MARQINET 1	Hiqet (është Gëzim Ali Alla qe është trajtuar ne VKM, nr. 630 lidhja nr.1. Nr,78
8	AGIM		ALLA	SHTEPI BANIMI	MARQINET 2	Hiqet (është Gëzim Ali Alla qe është trajtuar ne VKM, nr. 630, lidhja nr.1 Nr.79
9	LATIF	HARIZ	GERDECI	SHTEPI BANIMI	MARQINET 2	Përsëritet 2 here ne VKM 630, lidhja nr. 2, me nr. rendor 191-192
10	PETRIT	ALI	ALLA	SHTEPI BANIMI	MARQINET 2	Hiqet (është Petrit Hazis Alla qe është trajtuar ne VKM, nr. 630, lidhja 2. nr. 211
11	ABDYL	SHAQIR	MUKA	SHTEPI BANIMI	MARQINET	Përsëritet 2 here ne VKM nr. 630, lidhja nr. 2, me nr. rendor 74-159
12	GEZIM	HASAN	HASA	SHTEPI BANIMI		Është Gëzim Hasan Hysa ne lidhjen nr. 2 te VKM nr. 630, nr. 121

Shënim: Mbyllet me numër rendor 12 dymbëdhjetë.

Lidhja nr.2

EMRAT E FAMILJEVE TË CILAT SHTOHEN PËR TRAJTIM ME NDIHMË FINANCIARE, PËR PAGESËN E QIRASË TË BANESËS

Nr.	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	OBJEKTI	ADRESA	SASIA NE LEKE E NDIHMES QE PERFITON
1	RAMIZ	FERHAT	GERDECI	SHTEPI BANIMI	GERDEC	150,000
2	AVNI	HAMZA	SITA	SHTEPI BANIMI	MARQINET 2	150,000
3	HAMDI	REXHEP	KRASNIQI	SHTEPI BANIMI	MARQINET 2	150,000
4	FERIT	HAMDI	KRASNIQI	SI-ITEPI BANIMI	MARQINET 2	150,000
5	HAKI	BAFTJAR	PICARI	SHTEPI BANIMI	MARQINET 2	150,000
6	BESNIK	NURI	GERDECI	SHTEPI BANIMI	MARQINET 1	150,000
7	SHERIF	SAMI	LAZRI	SHTEPI BANIMI	MARQINET 1	150,000
8	BEDRI	SALI	DISHA	SHEPI BANIMI	MARQINET 2	150,000
9	BESIM	HYSEN	ALIU	SHTEPI BANIMI	MARQINET 2	150,000
10	QERIM	AHMET	ALIU	SHTEPI BANIMI	MARQINET 2	150,000
11	XHEVAHIR	FEIM	TOLELLARI	SHTEPI BANIMI	MARQINET	150,000
12	BESNIK	BAJRAM	BRETI	SHTEPI BANIMI	MARQINET 1	150,000
13	BLERIM	HAMZA	RRAPI	SHTEPI BANIMI	MARQINET 2	150,000
14	FATOS	HAMZA	SITA	SHTEPI BANIMI	MARQINET 2	150,000
15	LIRI	NEXHMEDIN	MJESHTRI	SHTEPI BANIMI	MARQINET	150,000
16	KUJTIM	BAJRAM	PICARI	SHTEPI BANIMI	MARQINET 2	150,000
17	HEKURAN	JAHIR	CUBI	SHTEPI BANIMI	MARQINET 2	150,000
18	GANI	BAJRAM	PREVIZI	SHTEPI BANIMI	MARQINET 1	150,000
19	SEFER	LLAZAN	DUSHKU	SHTEPI BANIMI	MARIKAJ	150,000
20	FORCIM	GANI	SPAHIU	SHTEPI BANIMI	MARQINET	150,000
21	HAKI	TAHIR	NUHILLARI	SHTEPI BANIMI	MARQINET	150,000
22	AGIM	YMER	MANE	SHTEPI BANIMI	VORE	150,000
23	LUFTI	HOD	LIKA	SHTEPI BANIMI	MARQINET	150,000
24	XHEMALI	IBRAHIM	PICARI	SHTEPI BANIMI	MARQINET 2	150,000
25	PETRIT	ISLAM	ISMAILI	SHTEPI BANIMI	MARQINET 1	150,000
26	SKENDER	HAJDAR	HAJDARI	SHTEPI BANIMI	MARQINET 1	150,000
27	BASTRI	ABDULLA	DRAGJOSHI	SHTEPI BANIMI	MARQINET1	150,000
28	REXHEP	ISLAM	ISMAILI	SHTEPI BANIMI	MARQINET 1	150,000
29	ERVIN	IBRAHIM	KOLA	SHTEPI BANIMI	MARQINET	150,000
30	HASAN	ISLAM	HASANI	SHTEPI BANIMI	MARQINET	150,000
31	ALFRED	SHAQIR	GERDECI	SHTEPI BANIMI	GERDEC	150,000
32	VAJE	HAXHI	PICARI	SHTEPI BANIMI	MARQINET	150,000
33	BESIM	ISLAM	ISMAILI	SHTEPI BANIMI	MARQINET	150,000
34	FITIM	JONUZ	TANUSHI	SHTEPI BANIMI	MARQINET 2	150,000
TOTALI						5,100,000

Shënim: Mbyllet me numër rendor 34 (tridhjetë e katër).

VENDIM
Nr.39, datë 14.1.2009

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË DYTË KOMBËTAR, PERIODIK, NË KUADËR TË KONVENTËS “KUNDËR TORTURËS, TRAJTIMEVE APO DËNIMEVE TË TJERA TË EGRA, ÇNJERËZORE DHE DEGRADUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të ligjit nr.7727, datë 30.6.1993 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Kundër torturës, trajtimeve apo dënimeve të tjera të egra, çnjerëzore dhe degraduese””, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit të dytë kombëtar, periodik, në kuadër të konventës “Kundër torturës, trajtimeve apo dënimeve të tjera të egra, çnjerëzore dhe degraduese”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.51, datë 21.1.2009

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr.9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Kliti Ceca, anëtar i Këshillit të Statistikave, lirohet nga ky funksion.
2. Znj. Diana Shtylla emërohet anëtar i Këshillit të Statistikave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.54, datë 21.1.2009

PËR SHKARKIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe të pikës 6 të vendimit nr.566, datë 23.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Tunxh Prel Vatnikaj, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, shkarkohet nga kjo detyrë.

2. Z. Elvis Çefa emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.93, datë 21.1.2009

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRGJITHSHËM ANALITIK TË PROJEKTAKTEVE,
QË DO TË PARAQITEN PËR SHQYRTIM NË KËSHILLIN E MINISTRAVE,
GJATË VITIT 2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2008, sipas tabelave, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.113, datë 2.2.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES DHE FILLIMIN E PROCEDURAVE
PËR DHËNIEN ME KONCESION TË SHËRBIMIT TË REGJISTRIT TË BARRËVE
SIGURUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8537, datë 18.10.1999 “Për barrët siguruese”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të Shërbimit të Regjistrimit të Barrëve Siguruese, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Fillimin e procedurave për dhënien me koncesion të këtij shërbimi.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.120, datë 14.1.2009

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.817, DATË 11.6.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E VLERËS SË DËMEVE, TË SHKAKTUARA NË OBJEKTET, PRONË PRIVATE, SI RRJEDHOJË E AKSIDENTIT TEKNOLOGJIK, TË NDODHUR NË GËRDEC, DHE TË LISTAVE ME EMRAT E INDIVIDËVE DHE PERSONAVE FIZIKË DHE JURIDIKË, QË DO TË KOMPENSOHEN, SI REZULTAT I PROCESIT TË VLERËSIMIT DHE TË RIVLERËSIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “dh” të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të nenit 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.817, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave të bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikën 1, vlera “...935 900 412 (nëntëqind e tridhjetë e pesë milionë e nëntëqind mijë e katërqind e dymbëdhjetë) lekë...”, ndryshohet dhe bëhet “... 1 021 098 820 (një miliard e njëzet e një milionë e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e njëzet) lekë”

b) Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3.Miratimin e listave nr.1, 2, 3 e 4, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me emrat e individëve e të personave fizikë a juridikë, dhe të vlerave përkatëse të kompensimit, si rezultat i procesit të vlerësimit e rivlerësimit të objekteve, që kanë në pronësi.”.

2.Ngarkohet bashkia e Vorës të ndjekë procedurat ligjore përkatëse për arkëtimin e shumës, në favor të Buxhetit të Shtetit, nga personat, që, si rezultat i procesit të rivlerësimit, kanë përfituar padrejtësisht.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

Tabela nr.1

LISTA E PERSONAVE ME SHTËEPI TË SHKATËRRUAR TOTALISHT, ORENDITË E TË CILAVE JANË VLERËSUAR DUKE U MBËSHTETUR NË VKM, DATË 23.3.2008

NR	Emri i pronarit	Emërtimi i objektit	Adresa	Vlera e pajisjeve dhe orendive tek vlerësimi i pare	Vlera e pajisjeve dhe orendive që duhet të marrë sipas VKM	Diferenca që duhet të marrë/në lekë
1	Abdulla Murat Murati	Shtëpi banimi	MARQINET	500000	1200000	700000
2	Abdyi Shaqir Muka	Shtëpi banimi	MARQINET	80000	800000	720000
3	Adem Riza Dragjoshi	Shtëpi banimi	MARQINET	0	800000	800000
4	Afërdita Jonuz Picari	Shtëpi banimi	MARQINET 2	479000	1000000	521000
5	Agim Ramazan Aliu	Shtëpi banimi	MARQINET	439000	800000	361000
6	Ali Myslym Zguri	Shtëpi banimi	MARQINET	0	1200000	1200000
7	Altin Sherif Muka	Shtëpi banimi	MARQINET	0	500000	500000
8	Arben Ali Gërdeci	Shtëpi banimi	GERDEC	0	600000	600000
9	Arjan Mehmet Collaku	Shtëpi banimi	MARQINET	187500	500000	312500
10	Astrit Shaqir Gërdeci	Shtëpi banimi	GERDEC	800000	1000000	200000
11	Astrit Sinan Halili	Shtëpi banimi	MARQINET	542500	1000000	457500
12	Avni Gani Aliu	Shtëpi banimi	MARQINET	0	800000	800000
13	Avni Rushit Cani	Shtëpi banimi	MARQINET 2	0	1000000	1000000
14	Bajram Mustafa Murati	Shtëpi banimi	MARQINET 2	378500	1600000	1221500
15	Bajram Ramazan Leti	Shtëpi banimi	MARQINET	0	800000	800000
16	Baki Ramazan Halili	Shtëpi banimi	MARQINET 2	589500	800000	210500
17	Bakushe Myslym Aliu	Shtëpi banimi	MARQINET	0	600000	600000
18	Bashkim Xhemal Gërdeci	Shtëpi banimi	GERDEC	36500	600000	563500
19	Bedri Sali Disha	Shtëpi banimi	MARQINET 2	653500	800000	146500
20	Beqir Abedin Primi	Shtëpi banimi	MARQINET 2	0	1200000	1200000
21	Besim Muharrem Kula (Gramshi)	Shtëpi banimi	MARQINET 2	0	800000	800000
22	Besnik Beqir Kapllani	Shtëpi banimi	MARQINET	0	800000	800000
23	Dashamir Fadil Aliu	Shtëpi banimi	MARQINET 2	224000	800000	576000
24	Dritan Haki Aliu	Shtëpi banimi	MARQINET 2	0	800000	800000
25	Elmi Ramiz Visha	Shtëpi banimi	MARQINET	0	500000	500000
26	Enver Petrit Murati	Shtëpi banimi	MARQINET	483500	800000	316500
27	Fadil Asllan Gjokola	Shtëpi banimi	MARQINET 2	0	600000	600000

28	Fatmir Hasan Aliu	Shtëpi banimi	MARQINET	60000	800000	740000
29	Fatmir Haxhi Ceka	Shtëpi banimi	MARQINET	500000	600000	100000
30	Fatmir Ramazan Dauti	Shtëpi banimi	MARQINET 2	443000	800000	357000
31	Fetah Nezir Hasa	Shtëpi banimi	MARQINET 2	1000000	1400000	400000
32	Gëzim Ali Alla	Shtëpi banimi	MARQINET	0	1200000	1200000
33	Gëzim Bajram Breti	Shtëpi banimi	MARQINET 1	500000	1200000	700000
34	Gëzim Can Hysa	Shtëpi banimi	MARQINET	0	1400000	1400000
35	Hajdar Ymer Aliu	Shtëpi banimi	MARQINET	0	1400000	1400000
36	Hamid Muharrem Aliu	Shtëpi banimi	MARQINET	0	800000	800000
37	Haxhi Ibrahim Gjikota	Shtëpi banimi	MARQINET	0	600000	600000
38	Haxhi Ramadan Zguri	Shtëpi banimi	GERDEC	12000	1200000	1188000
39	Homet Laze Hazizaj	Shtëpi banimi	MARQINET 2	0	2600000	2600000
40	Hysen Riza Musollari	Shtëpi banimi	MARQINET	0	1000000	1000000
41	Ibrahim Ahmet Kola	Shtëpi banimi	MARQINET 2	612000	800000	188000
42	Iir Mustafa Picari	Shtëpi banimi	MARQINET	749832	800000	50168
43	Islam Ahmet Aliu	Shtëpi banimi	MARQINET 2	391000	500000	109000
44	Isuf Baki Gërdeci	Shtëpi banirni	MARQINET	553500	600000	46500
45	Kasem Ramadan Zguri	Shtëpi banimi	MARQINET	0	1000000	1000000
46	Klodian Sherif Muka	Shtëpi banimi	MARQINET	0	500000	500000
47	Lulëzim Petrit Murati	Shtëpi banimi	MARQINET	288000	500000	212000
48	Lulëzim Ramazan Aliu	Shtëpi banimi	MARQINET	620000	800000	180000
49	Mehmet Limon Collaku	Shtëpi banimi	MARQINET 2	579000	600000	21000
50	Mersin Bajram Osmani	Shtëpi banimi	MARQINET 2	0	600000	600000
51	Misar Sherif Muka	Shtëpi banimi	MARQINET	0	500000	500000
52	Mustafa Ali Tafaj	Shtëpi banimi	MARQINET	233000	1000000	767000
53	Mustafa Tahir Gërdeci	Shtëpi banimi	GERDEC	500000	1200000	700000
54	Myrvete Myslym Lala	Shtëpi banimi	MARQINET 2	616500	1000000	383500
55	Naim Hasan Kurti	Shtëpi banimi	MARQINET	472200	1800000	1327800
56	Nazif Ibrahim Disha	Shtëpi banimi	MARQINET	0	800000	800000
57	Nuri Muharrem Osmani	Shtëpi banimi	MARQINET	524000	800000	276000
58	Pëllumb Shaqir Muka	Shtëpi banimi	MARQINET	0	600000	600000
59	Përparim Ramadan Zguri	Shtëpi banimi	MARQINET 2	0	1000000	1000000
60	Petrit Ali Alla	Shtëpi banimi	MARQINET 2	0	1000000	1000000
61	Qani Ali Aliu	Shtëpi banimi	MARQINET 2	429000	600000	171000
62	Qemal Vesel Celami	Shtëpi banimi	MARQINET 2	0	800000	800000
63	Qenan Kamber Durdaj	Shtëpi banimi	MARQINET 2	802500	1200000	397500
64	Ramazan Ahmet Aliu	Shtëpi banimi	MARQINET	256000	500000	244000
65	Ramazan Mahmut Demirxhiu	Shtëpi banimi	GERDEC	500000	600000	100000
66	Ramiz Osman Visha	Shtëpi banimi	MARQINET	286500	600000	313500

67	Resmi Ferhat Gërdeci	Shtëpi banimi	MARQINET	0	500000	500000
68	Rexhep Asllan Zguri	Shtëpi banimi	MARQINET	0	1800000	1800000
69	Rexhep Ibrahim Gjikota	Shtëpi banimi	MARQINET	0	1000000	1000000
70	Rruzhdin Xhemal Gjergji	Shtëpi banimi	MARQINET 1	0	1200000	1200000
71	Rustem Beqir Gjika	Shtëpi banimi	MARQINET 2	460532	1000000	539468
72	Rustem Hasan Aliu	Shtëpi banimi	MARQINET	538000	600000	62000
73	Rustem Ramazan Halili	Shtëpi banimi	MARQINET 2	0	1200000	1200000
74	Sadik Asllan Gjikota	Shtëpi banimi	MARQINET	225000	1600000	1375000
75	Sahit Hamit Ceka	Shtëpi banimi	GERDEC	0	1200000	1200000
76	Sami Myslym Aliu	Shtëpi banimi	MARQINET 2	542000	1000000	458000
77	Sefer Gani Aliu	Shtëpi banimi	MARQINET	0	500000	500000
78	Selami Shaban Sula	Shtëpi banimi	MARQINET 2	616000	1200000	584000
79	Shaban Beqir Kenga	Shtëpi banimi	MARQINET	0	500000	500000
80	Shaban Nesim Sula	Shtëpi banimi	MARQINET	275000	500000	225000
81	Shefqet Ymer Aliu	Shtëpi banimi	MARQINET	359000	1400000	1041000
82	Shkëlqim Ibrahim Gjikota	Shtëpi banimi	MARQINET	0	1000000	1000000
83	Shkëlqim Osman Picari	Shtëpi banimi	MARQINET 2	0	500000	500000
84	Spartak Halit Mullaymeri	Shtëpi banimi	MARQINET	470500	800000	329500
85	Sure Shaban Gërdeci	Shtëpi banimi	GERDEC	56000	800000	744000
86	Vesel Esat Muca	Shtëpi banimi	GERDEC	1200000	2000000	800000
87	Xhavit Mustafa Picari	Shtëpi banimi	MARQINET 2	800000	1200000	400000
88	Zenel Maksut Aliu	Shtëpi banimi	MARQINET	0	500000	500000
89	Zeqir Dalip Aliu	Shtëpi banimi	MARQINET	200500	600000	399500
90	Zyra Isuf Muka	Shtëpi banimi	MARQINET	500000	600000	100000
91	Brahim Elez Caka	Shtëpi banimi	MARQINET			800000
92	Hamza Hajrulla Rrapi	Shtëpi banimi	MARQINET			1392000
93	Beqir Xhaferr Ismaili	Shtëpi banimi	MARQINET			694000
94	Ibrahim Ahmet Kola	Shtëpi banimi	MARQINET			988000
95	Hajdar Ibrahim Picari	Shtëpi banimi	MARQINET			694200
	VLERA TOTALE			22564064	81600000	63604136

Tabela nr.2

LISTA E PERSONAVE, ME SHTEPI TË DËMTUARA, ME RIVLERËSIMET E DËMEVE (BASHKIA VORË)

NR	EMRI I FAMILJARIT	Emërtimi i objektit	ADRESA	Vlera ndërtimore	Vlera e orendive	Vlera 1 +2	Marrë me VKM nr.336 datë 23.03.08 (3)	Marrë me VKM nr. 817 (4)	Vlera 3+4	Diferenca për t'u marrë
1	Bujar Brahim BRUSHA	Shtëpi banimi	VORE	396200	0	396200	0	0	0	396200
2	Dilaver Kasem ISMAILI	Shtëpi banimi	MARQINET 1	838885	3000	841885	298700	434105	732805	109080
3	Eduart VISHA	Shtëpi banimi	MARQINET 1	968189	399500	1367689	1191169	0	1191169	176520
4	Xhevdet Hamdi XHAFJA	Shtëpi banimi 1+2	MARQINET 2	500985	107500	608485	223593	161299	384892	223593
5	Basri Destan LAMI	Shtëpi banimi 1+2	MARQINET 2	2961905	1200000	4161905	262661	3636583	3899244	262661
6	Latif Hariz GERDECI	Bar-Restorant	MARQINET	8747550	3996900	12744450	1303400	446110	1749510	10994940
7	Haki Hasan MATRANXH	Shtëpi banimi	MUCAJ	116459	0	116459	116459	-116459	0	116459
8	Osman PICARI	Stalle bagëtie	MARQINET	235021	0	235021	235021	-235021	0	235021
9	Petrit Hajdar HAJDARI	Shtëpi banimi	MARQINET	1453824	0	1453824	76364	377740	454104	999720
10	Fatmir Hasan ALIU	Shtëpi banimi	MARQINET	225681	289000	514681	0	0	0	514681
11	Fatmir Hasan ALIU	Karb + Magazine	MARQINET	535299	0	535299	0	0	0	535299
12	Myslym Zenel ALIU	Shtëpi banimi 1+2	MARQINET	5773383	600000	6373383	2139496	2434391	4573887	1799496
13	Haxhi Hysen CEKA	Shtëpi banimi 1+2	MARQINET	1493111	1200000	2693111	285461	2164189	2449650	243461
14	Gani Bajram DERVISHI	Shtëpi banimi	MARQINET	135060	0	135060	0	75140	75140	59920
15	Ramadan KOLDASHI	Objekt	MARQINET	324520	0	324520	0	0	0	324520
16	Admir MURATI	Shtëpi banimi	KASHAR	275835	0	275835	0	0	0	275835
17	Ahmet Ismail PICARI	Shtëpi banimi	MARQINET	662367	391000	1053367	0	0	0	1053367
18	Bashkia VORE	Zyrat	VORE	1222872	480000	1702872	0	0	0	1702872
	VLERA TOTALE			26867146	8666900	35534046	6132324	9378077	15510401	20023645

Tabela nr.3

**LISTA E PERSONAVE ME SHTEPI TË DËMTUARA, TË RIVLERËSUARA DHE TË PAPUBLIKUARA ME VKM NR.817,
DATË 11.06.2008, BASHKIA MANZË**

NR	EMRI I FAMILJARIT	Emërtimi i objektit	ADRESA	Vlera ndërtimore	Vlera orendi	Vlera 1+2	Marrë me VKM nr.336	Marrë me VKM 817	Vlera	Diferenca për tu marrë	
1	Hasan Zenel BASHA	Shtëpi banimi	RADE	49240	0	49240	0	0	0	49240	I papublikuar
2	Ahmet Muharrem GJERGJI	Shtëpi banimi	RADE	107190	0	107190	0	0	0	107190	I papublikuar
3	Sherif Hysen GJERGJI	Shtëpi banimi	RADE	22850	0	22850	0	0	0	22850	I papublikuar
4	Ramiz Muharrem GJERGJI	Shtëpi banimi	RADE	37530	0	37530	0	0	0	37530	I papublikuar
5	Ferik Ali HUSHI	Shtëpi banimi	KAMERRAS	0	0	0	0	41283	0	-41283	Shtuar gabim
6	Dashamir OSTRENI	Bar-Restorant	BORAKE	50600	0	50600	0	25300	0	25300	Llog.gabim
	VLERA TOTALE			267410	0	267410	0	66583	0	200827	

Konfirmuar nga bashkia Manzë me shkresën nr.478, datë 11.8.08 për numrat (1-5).

LISTA ME EMRAT E PERSONAVE, TË CILËVE U ËSHTË LLOGARITUR VLERA E KAFSHËVE TË DEMTUARA, POR QË NUK IU ËSHTË MIRATUAR NË VKM-TË NR.336 DHE 817.

Nr	Emri i Pronarit	Vlera që duhet të marrë /në lekë
1	Shefqet Ymer Aliu	10800
2	Agim Alla	30000
3	Bajram Mustafa Murati	30000
4	Shaqir Avdyll Muka	30000
5	Sherif Misar Muka	30000
6	Agim Karaj	130000
7	Rruzhdin Hamit Sina	130000
8	Riza Bajram Halili	130000
9	Rustem Beqir Gjika	130000
10	Bajram Ibrahim Picari	130000
11	Shaban Baftjar Picari	130000
12	Agim Deliu	69000
13	Ahmet Ismail Picari	130000
14	Veli Abaz Picari	130000
15	Hysen Selim Hoxha	130000
	VLERA TOTALE	1369800

**VENDIM
Nr.130, datë 27.1.2009**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR DIALOGUN NDËRKULTUROR,
NË ZBATIM TË PLANIT DYVJEÇAR TË ALEANCËS SË QYTETËRIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë kombëtare për dialogun ndërkulturor, në zbatim të planit dyvjeçar të Aleancës së Qytetërimeve, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Integritit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nën bashkërendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj strategjie.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR DIALOGUN NDËRKULTUROR, NË ZBATIM TË PLANIT DYVJEÇAR TË ALEANCËS SË QYTETËRIMEVE

I - HYRJJE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në vijim të angazhimit të saj gjithnjë e më aktiv në gjirin e Kombeve të Bashkuara për nxitjen e kulturës së paqes, për nxitjen e bashkëjetesës dhe mirëkuptimit të ndërsjellë midis kombeve dhe popujve, në interes të paqes dhe prosperitetit të përbashkët, mbështet plotësisht objektivat e nismës së Sekretarit të Përgjithshëm Ban Ki-moon për Aleancën e Qytetërimeve.

Si anëtare e Grupit të Miqve të Aleancës së Qytetërimeve, Republika e Shqipërisë nëpërmjet qeverisë së saj jep përkrahjen e vet të plotë ndaj rekomandimeve të paraqitura nga Grupi i Nivelit të Lartë, ngritur posaçërisht më 2006 nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së dhe angazhohet të veprojë në përputhje me linjat e përcaktuara në Planin e Implementimit për dy vjetët e ardhshme, hartuar në vijim të Rekomandimeve të Grupit të Nivelit të Lartë nga Përfaqësuesi i Lartë i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Aleancën e Qytetërimeve (AoC), Presidenti Jorge Sampaio, për t'iu përgjigjur me qasje dhe projekte konkrete e, në vazhdimësi, rrezikut të ndarjeve artificiale ndërmjet komuniteteve me përkatësi kulturore, fetare apo etnike të ndryshme.

II- STRATEGJIA KOMBËTARE

Strategjia e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për dialogun ndërkulturor, ndërfetar e ndëretnik mbështetet në dokumente të tilla themeltare mbi të cilat bashkëpunimi i sotëm ndërkombëtar si Karta e Kombeve të Bashkuara, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, dokumentet e AoC-së, si dhe në angazhimet e ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe institucionet e tjera të larta shtetërore shqiptare në vazhden e plotësimin të standardeve të parashikuara në kuadër të procesit për integrimin euro-atlantik dhe të Konventës së UNESCO-s për mbrojtjen dhe nxitjen e shprehjeve kulturore dhe artistike.

Kjo strategji bazohet, gjithashtu, në trashëgiminë e shkëlqyer të harmonisë ndërkonfesionale në Shqipëri dhe reflekton, përmes identifikimit të fushave të veprimit, në plan kombëtar, por edhe në plan rajonal e më gjerë, praktikën e deritanishme pozitive në menaxhimin e dialogut ndërkulturor, ndërfetar dhe ndëretnik.

Hartimi i kësaj strategjie është në frymën e vullnetit të shprehur politik të qeverisë dhe të institucioneve të tjera të larta shtetërore shqiptare për t'i shërbyer me sinjeritet përmirësimit të vazhdueshëm të marrëdhënieve ndërmjet tri komuniteteve fetare ekzistuese në Shqipëri, atij mysliman, atij ortodoks e atij katolik, si dhe po ashtu për t'u shërbyer marrëdhënieve harmonike të shumicës së popullsisë shqiptare me minoritetet etnike apo kulturore në vend. Objektivi po kaq i rëndësishëm është edhe kontributi për përmirësimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve ndëretnike e ndërshtetërore në të gjithë rajonin, në katër fushat e përcaktuara nga Aleanca e Qytetërimeve në OKB, përkatësisht në fushën e arsimit, në çështjet e rinisë, të emigracionit dhe të medias.

Në zbatimin e strategjisë kombëtare për dialogun ndërkulturor, ndëretnik e ndërfetar, Qeveria e Republikës së Shqipërisë synon të përfshijë drejtpërdrejt disa nga ministritë kryesore, si edhe të bashkëpunojë ngushtë me organizatat joqeveritare, të cilat do të përpilojnë planet e tyre konkrete, bazuar në këtë strategji dhe në parimet themelore të AoC-së, sipas të cilave diversiteti është burim zhvillimi dhe se çdo mosmarrëveshje apo keqkuptim mund dhe duhet të zgjidhet përmes njohjes më të mirë të vlerave të njëri-tjetrit, me anë të dialogut.

Gjithë puna për zbatimin e kësaj strategjie do të ndërtohet në bashkëpunim dhe bashkërendim me AoC, me agjencitë e Kombeve të Bashkuara, me BE, OSBE, si dhe organizata dhe qendra të tjera të rëndësishme, rajonale dhe globale, të cilat zhvillojnë veprimtari në mbështetje të dialogut ndërkulturor, ndërfetar apo ndëretnik. Po ashtu, projekte bashkëpunimi në frymën e AoC do t'u propozohen me përparësi edhe fqinjëve, në kuadrin e intensifikimit të marrëdhënieve dypalëshe me secilin prej tyre.

Në këtë kontekst, Qeveria e Republikës së Shqipërisë, do t'u bashkohet vendeve të AoC-së dhe atyre të përfshira në nismat e Partneritetit Euromesdhetar për të realizuar gjatë vitit 2008, me projekte e veprimtari të shumëllojshme, vitin e dialogut ndërkulturor dhe vitin ndërkombëtar të gjuhëve, të shpallura nga Kombet e Bashkuara.

Po brenda vitit 2008, Qeveria e Republikës së Shqipërisë angazhohet që të organizojë Forumin e Dialogut Ndërkonfesional në Europën Juglindore. Ky forum do të pasojë Konferencën e Tiranës, të zhvilluar, me këtë temë, në dhjetor të vitit 2004, dhe do të hapë siparin e mbledhjeve periodike, në nivel të lartë, të cilat, duke përcjellë trashëgiminë e suksesshme të shoqërisë shqiptare në bashkëjetesën e të tri komuniteteve fetare, do ta kthejnë Tiranën në një qendër të debatit dhe të zgjidhjeve ndaj sfidave dhe rreziqeve të reja, që rrjedhin nga konfliktet, stereotipet apo paragjykimet ndërkonfesionale.

III - FUSHAT KRYESORE TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE

Objektiv i rëndësishëm është edhe kontributi për përmirësimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve ndëretnike e ndërshtetërore në të gjithë rajonin, në katër fushat e përcaktuara nga Aleanca e Qytetërimeve në OKB, përkatësisht në fushën e arsimit, në çështjet e rinisë, të emigracionit dhe të medias.

1. ARSIMI

Sistemi arsimor edhe në Shqipëri, si kudo, përballet aktualisht me sfidën e përgatitjes së brezit të ri në kontekstin e një bote të ndërvarur, e cila nuk mund të jetë dhe nuk duhet të jetë e mbyllur në kufijtë e identiteteve komunitare. Njohja me historinë e popujve apo komuniteteve të tjera me përkatësi kulturore, fetare apo etnike të ndryshme, çimenton sensin e fatit të përbashkët të njerëzimit dhe të solidaritetit midis individëve, komuniteteve apo etnive të ndryshme. Njohja e tjetrit me sinqeritet shton posaçërisht në Ballkanin Perëndimor mundësinë për shkaputje të shëndetshme nga urrejtjet apo qoftë edhe keqkuptimet e së kaluarës, ushqen dialogun dhe respektin për njëri-tjetrin, i çel rrugën vështrimit të popujve nga e ardhmja e përbashkët europiane. Kjo prerogativë merr rëndësi të jashtëzakonshme edhe me gjerë, në krejt rajonin e Europës Juglindore, në këtë rast, ku proceset integruese euroatlantike shoqërohen, ende, me paragjykime ku me shumë e ku më pak të dukshme, gjithsesi me rrënjë të thella historike, për sa i përket marrëdhënieve të fqinjësisë mes popujve.

Në këtë kuadër, Qeveria e Republikës së Shqipërisë synon të vazhdojë e të thellojë punën e filluar pak vite më parë me nxitjen e UNESCO-s, të Komisioneve të Përbashkëta Ndërshtetërore me vendet fqinje për rishikimin e teksteve të historisë për shkollat, në mënyrë që këto tekste të pastrohen nga shprehjet e frymës së urrejtjes ndëretnike apo të përçmimit të një populli ndaj popullit tjetër, të cilat ende mbijetojnë si reminishenca të një të kaluarë dramatike në marrëdhëniet mes fqinjëve dhe ku merr krahë vetëm nacionalizmi. Me zgjidhjen e statusit të Kosovës, në favor të pavarësisë, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'i propozojë edhe Serbisë ngritjen e një komisioni të tillë të përbashkët.

Në përgjigje të planit të implementimit për dy vjetët e ardhshme të AoC-së, Ministria e Arsimit do të mbështesë financiarisht një organizatë joqeveritare shqiptare, që punon në fushën e aleancës mes qytetërimeve për të realizuar përkthimin dhe përhapjen sa më të gjerë, veçanërisht te rinia, të historisë së njerëzimit, projekt i konfirmuar i UNESCO-s, si një instrument i vyer në duart e mbarë shoqërisë shqiptare për të njohur vlerat e trashëguara nga njerëzimi i sotëm përkitazi me nxitjen e respektit dhe të solidaritetit të ndërsjellë mes popujve dhe komuniteteve me identitete të ndryshme kulturore, etnike apo fetare, por edhe për të ndihmuar përtej tabuve të trashëguara në kuptimin e drejtë nga të gjithë qytetarët të zhvillimit kulturor të njerëzimit si një proces i pandërprerë dhe i shumanshëm shkëmbimi vlerash dhe jo mbijetese realitetesh të izoluara njëri nga tjetri.

Arsimi kombëtar shqiptar, në format e veta më të shumëllojshme, përfshirë natyrisht edhe formimin e brezit të ri me muzikën, sportet, teatrin e filmin, duhet të synojë forcimin e urave të komunikimit ndërmjet bashkësive dhe popujve me përkatësi të ndryshme etnokulturore dhe fetare

dhe shmangien deri në fund të qëndrimeve përjashtuese individuale apo kolektive, sipas të cilave, interesat e një grupi kulturor, fetar, apo etnik janë eprorë e mund të mbivendosen në dëm të interesave të grupeve të tjera, apo dhe se viktimizimi historik i një grupi mund të justifikojë në një rrethanë të caktuar dhunën hakmarrëse ndaj grupeve të tjera.

2. RINIA

Rritja globale e lëvizjeve dhe organizatave rinore, gjatë viteve të fundit, ka hapur mundësi të reja edhe për mobilizimin e rinisë shqiptare. Programet e shkëmbimeve studentore, veprimtaritë sportive, një përfshirje publike dhe politike më aktive e rinisë, krijojnë hapësira më të përshtatshme edhe për nxitjen e mirëkuptimit ndërkulturor dhe të respektit ndaj diversitetit në përgjithësi.

3. EMIGRACIONI

Aktualisht vendi ka fluksin më të lartë të emigrimit në Europë, rreth 25% e popullsisë së përgjithshme ose rreth 35% e popullsisë aktive. Trajtimi i këtij fenomen, në planin e integritetit të tyre, paraqet problematikë të veçantë, po të mbajmë parasysh se sfidat e reja me të cilat përballen vendet pritëse, reflektojnë ndërveprimin midis popullsive me pikëpamje të ndryshme etnike dhe konfesionale.

4. MEDIA

Media, në të gjitha format e veta, ka potencialin për të shërbyer si një urë ndërmjet kulturave dhe shoqërive.

LISTA E VEPRIMTARIVE

1. ARSIMI

Edukimi qytetar dhe për paqen: Edukimi qytetar si lëndë shkollore krijon hapësirën e duhur për trajtimin me adoleshentët dhe të rinjtë të çështjeve të identitetit dhe për kultivimin tek ata të respektit ndaj diversitetit. Ideologjitë radikale nxisin një botë të shënuar nga vullnete agresive e përjashtuese. Për këtë arsye, përjasje të tilla duhet të mënjanojnë përmes zhvillimit të ndjenjës së respektit ndaj kulturave të ndryshme, bazuar mbi vlerat dhe idealet e përbashkëta. Nëse duam realisht të jetojmë në një botë pluraliste, është domosdoshmëri që qytetarët të përballen me këto parime, të sanksionuara në Deklaratën Universale të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe në dokumentet themelore të UNESCO-s për Diversitetin Kulturor.

Arsimi gjithëpërfshirës dhe ndërkulturor: Ky objektivi duhet të synojë rritjen e frekuentimit të nxënësve në arsimin e detyruar, veçanërisht të disa kategorive më të prekshme dhe problematike, siç janë femrat dhe fëmijët romë. Për këtë kategori të fundit duhet thelluar puna në vazhden e VKM-së, nr.633, datë 18.9.2003 “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”, si dhe të udhëzimit, nr.6, datë 29.3.2006 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikatë lindje”. Gjithashtu, për kategoritë e mësipërme (femrat dhe persona nga komuniteti rom) do të vijojë puna e mirë e nisur në ofrimin e formimit profesional falas, bazuar në urdhrin nr.782, datë 4.4.2006 të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, duke iu krijuar atyre shanse reale për t’u integruar në tregun e punës.

1.3 Programet e shkëmbimeve, në nivel pasuniversitar: Përvojat e viteve të fundit, si në rastin e Programit Erasmus të Komisionit Europian, kanë treguar se programet e shkëmbimeve për profesorët e universiteteve dhe studentët pasuniversitarë, kanë ndikim vetëm pozitiv. Këto shkëmbime janë dëshmuar me shumë dobi për transferimin e dijeve shkencore, të cilat, në vetvete, përbëjnë një faktor kyç për nxitjen e zhvillimit të një vendi ende në tranzicion demokratik, si Shqipëria. Nga ana tjetër, përvoja jonë në periudhën postdiktatoriale prej afro një dekade e gjysmë, provon se programe të tilla shkëmbimesh janë të dobishme edhe për njohjen më të mirë individualisht të kulturave të popujve të tjerë nga profesorët dhe studentët shqiptarë, të cilët dilnin nga një periudhë e gjatë izolimi dhe ksenofobie. Qeveria shqiptare do t’i kërkojë Komisionit Europian shtimin e këtyre programeve në vitet e ardhshme, si kontribut substancial që Bashkimi Europian do t’i japë shoqërisë shqiptare për transformimin e mentalitetit. Po ashtu, qeveria shqiptare do të propozojë për t’u dhënë vend më të madh programeve të tilla në marrëveshjet dypalëshe për shkëmbimet kulturore me të gjitha vendet mike, përfshirë edhe ato myslimane. Qeveria shqiptare

shpreh nga ana e vet vullnetin të presë studentë dhe profesorë nga këto vende mike në universitetet e saj.

1.4 Arsimi dhe feja: E drejta për të zgjedhur dhe praktikuar besimin individual pa pengesë, është e sanksionuar në nenin 18 të deklaratës universale për të drejtat e njeriut. Sistemi arsimor i vendit, përfshirë shkollat private fetare që ekzistojnë në Shqipëri, duhet të rishikojë të gjithë programet, në mënyrë që lëndët e mësuara, t'u përçojnë nxënësve mirëkuptimin dhe respektin ndaj besimeve dhe praktikave të ndryshme fetare e ndaj kulturave të tjera të botës. Jo vetëm elitat, por e gjithë shoqëria ka nevojë për një njohje korrekte dhe respekt të traditave fetare të tjetrit.

1.5 Teknologjitë e reja të informacionit dhe aksesit në internet: Përhapja, në mënyrë të pabarabartë, e kompjuterëve dhe mungesa e aksesit në internet, veçanërisht në zonat rurale, pengon përshtatjen me konceptet e ndërkulturalitetit. Pa një përhapje të gjerë të aksesit në internet, veçanërisht në sistemin shkollor, popullsitë e këtyre zonave rurale do ta kenë të pamundur të marrin plotësisht pjesë në procesin e aksesit ndaj informacionit dhe për pasojë, mbeten ku më shumë e ku më pak jashtë efekteve ndërvepruese të një bote shumëkulturore. Objektivi i qeverisë shqiptare për ta shtrirë shërbimin e internetit në të gjithë shkollat e mesme të vendit, brenda gjysmës së parë të 2009, përputhet plotësisht me qëllimet e AoC për dy vjetët e ardhshme. Objektiva të tilla, ku veçanërisht përfitojnë të rinjtë e zonave rurale, duhen shoqëruar me një mbështetje të vazhdueshme kombëtare dhe ndërkombëtare për krijimin e siteve elektronike, të cilat të kenë në thelb të përmbajtjes mirëkuptimin dhe dialogun ndërkulturor.

1.6 Arsimi për punësimin dhe jetën: Qeveria e Republikës së Shqipërisë e ka në qendër të vëmendjes reformimin e sistemit arsimor, me qëllim që ai t'i përgjigjet cilësisht përgatitjes të brezit të ri në raport me punësimin. Ky objektivi i qeverisë po gjen realizim në praktikë nëpërmjet përsosjes së programeve të shkollave të mesme të përgjithshme, e sidomos nëpërmjet zgjerimit dhe shtrirjes në të gjithë vendin të rrjetit të shkollave të mesme të formimit profesional, të cilat po ngrihen dhe do të vazhdojnë të ngrihen në përputhje me kërkesat e parashikuara në strategjinë kombëtare të zhvillimit ekonomik të vendit, por edhe duke mbajtur parasysh profesionet më të kërkuara nga zyrat e punësimit për të huajt në Europën Perëndimore.

Në këtë aspekt t'i kushtohet rëndësi të mësuarit gjatë gjithë jetës, i cili bën të mundur transferimin nga njëri program në tjetrin brenda kornizës kombëtare të kualifikimeve, akumulimin dhe njohjen e krediteve për arritjet e fituara me forma dhe mënyra të ndryshme, formale, informale dhe joformale.

Integrimi European parashtron kërkesa të tilla, që e bëjnë të domosdoshëm përfshirjen e Arsimit dhe Formimit Profesional në rrjedhën e zhvillimeve bashkëkohore, në harmoni me ato çka po ndodhin në rajon dhe Bashkimin European. Ndikimet e proceseve të Bolonjës, Lisbonës dhe Kopenhagenit tashmë janë të pranishme dhe në Shqipëri dhe po ushtrojnë një "presion" pozitiv në nivelet politike për të kaluar nga "riparimet e pjesshme sipas nevojave të çastit" drejt "zgjidhjeve të plota e afatgjata" në kontekstin e integritit rajonal dhe european.

2. Rinia

2.1 Zgjerimi i mundësive për mobilizimin e rinisë: Rritja globale e lëvizjeve dhe organizatave rinore, gjatë viteve të fundit, ka hapur mundësi të reja edhe për mobilizimin e rinisë shqiptare. Programet e shkëmbimeve studentore, veprimtaritë sportive, një përfshirje publike dhe politike më aktive e rinisë, krijojnë hapësira më të përshtatshme edhe për nxitjen e mirëkuptimit, ndërkulturor dhe të respektit ndaj diversitetit, në përgjithësi. Për më tepër, mbështetja e posaçme për pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse, i sjell përfitime reale shoqërisë, duke pasur parasysh se brezi i ri përbën një burim për sjelljen e energjisë dhe të ideve të reja, në favor të ndryshimeve pozitive. Në këtë drejtim, është shumë e rëndësishme, që Ministria e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve të hartojë programe të larmishme, përmes të cilave të rinjtë të njihen nga mbarë shoqëria dhe të evidentohen, jo vetëm si burim mobilizimi, por edhe si aktorë në proceset transformuese të shoqërisë dhe partnerë autonomë të grupmoshave të tjera.

2.2 Shkëmbime programesh dhe veprimtarish të përbashkëta rinore në kuadrin ballkanik:

Shkëmbimet mes të rinjve janë një metodë efikase për tejkalimin e barrierave kulturore, rritjen e ndërgjegjësimit ndërkulturor dhe thellimin e zhvillimit individual të tyre. Në këtë kontekst, në rajonin tonë paraqesin interes programet që nxisin shkëmbime ndërmjet të rinjve që vijnë nga hapësira të ndryshme kulturore apo etnike, bazuar mbi modelet e suksesshme në rajonet e tjera të botës dhe mësimet e përftuara nga përvojat europiane dhe eurumesdhetare.

2.3 Përfshirja socio-ekonomike: Një problem shqetësues, ashtu si në plan global edhe në plan kombëtar, mbetet punësimi i të rinjve. Përpilimi i strategjive, që rrisin pjesëmarrjen e të rinjve në jetën ekonomike, veçanërisht në raport me nxitjen e shpirtit të ndërmarrjes, nga ana e tyre, përbëjnë mjete të rëndësishme për të luftuar dukurinë e papunësisë.

Hartimi i politikave aktive që synojnë të merren me të rinjtë në pozita të disfavorshme, duke kombinuar trajnimin me punësimin e subvencionuar për herë të parë dhe udhëzimet e këshillimit për formim profesional me programet e biznesit për të rinjtë, janë elemente të rëndësishme për të lehtësuar punësimin e të rinjve.

Një pjesë e madhe e të rinjve përfaqësues të komunitetit rom kanë qenë të papunë për një periudhë disavjeçare, dhe midis tyre, pjesa më e madhe nuk janë në gjendje që të gjejnë punë.

Arsye kryesore për nivelet e larta të papunësisë afatgjatë: te komuniteti rom lidhet me i) mungesën e shkollimit, ii) disavantazhet rajonale, iii) diskriminimin dhe iv) efikasitetin e ulët të politikave aktive të punësimin të komunitetit të romëve, për shkak se pjesa më e madhe e tyre nuk janë të regjistruar si të papunë.

Gjithashtu, një hap i rëndësishëm është i) identifikimi i profesioneve që mund të mësohen nga romët dhe ii) hapja e kurseve të formimit profesional për profesionet e identifikuar në qendrat publike dhe private të formimit profesional. Parashikohet ngritja e një grupi pune ndërministror, për hartimin e një strategjie afatshkurtër dhe afatmesme mbi punësimin e të rinjve, lehtësirat fiskale dhe mbështetjet e formave të tjera, nga ana e qeverisë, për ndërmarrjet që punësojnë të rinj, si edhe për vetë të rinjtë që guxojnë krijimin e ndërmarrjeve të tyre. Kjo strategji do të kërkojë edhe përshtatje të ndryshme ligjore dhe do të miratohet në Parlament, gjë që do ta sensibilizojë edhe Parlamentin lidhur me këtë problem të madh.

2.4 Nxitja e pjesëmarrjes: Përfshirja e të rinjve në nivel vendor, përkatësisht pranë këshillave bashkiake, organizatave rinore dhe njësisive ekzekutive të institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile, mund t'u sigurojë atyre mundësinë të marrin pjesë në hartimin e platformave të punës, për të marrë përsipër kështu edhe role konstruktive në bashkësitë ku bëjnë pjesë. Vitet e fundit, përfaqësimi i të rinjve ka njohur përvoja të reja pozitive, përmes ekzistencës së rrjeteve rajonale rinore. Këto rrjete, duhen shfrytëzuar më mirë nëpërmjet identifikimit të projekteve specifike, pasi lehtësojnë mobilizimin e të rinjve nga hapësira të ndryshme kulturore, fetare apo etnike.

3. EMIGRACIONI

3.1 Dimensioni dinamik i emigracionit: Aktualisht, shumica e vendeve të botës janë shndërruar në vend të origjinës apo të destinacionit të emigrantëve. Shqipëria, pas ndryshimeve të viteve 90-të njohu lëvizje masive të qytetarëve, që iu drejtuan kryesisht Greqisë dhe Italisë, por edhe vendeve të tjera europiane si dhe SHBA-së, për t'u punësuar si emigrantë. Aktualisht vendi ka fluksin më të lartë të emigrimit në Europë, rreth 25% të popullsisë së përgjithshme ose rreth 35% e popullsisë aktive. Trajtimi i këtij fenomeni, në planin e integritit të tyre, paraqet problematikë të veçantë, po të mbajmë parasysh se sfidat e reja me të cilat përballen vendet pritëse, reflektojnë ndërveprimin midis popullsisë me pikëpamje të ndryshme etnike dhe konfesionale. Në këtë kontekst, merr rëndësi mënyra se si dinamika e ndërveprimit të tyre pasqyrohet në media, se si diskutohet për këtë çështje nga liderët politikë dhe ata kulturorë, por edhe se si administrohet gjithë kjo problematikë nga ana e vendimmarrësve. Perceptimi i emigrantëve nga ana e popullsisë pritëse, e përcjell jehonën e vet të keqe ose të mirë në vendin e origjinës së emigrantëve, duke infektuar ose përmirësuar vetë perceptimin e popujve për njëri-tjetrin. Për rrjedhim, lind nevoja e ndërtimit të një pune të bashkërenduar midis qeverive, por edhe midis strukturave të shoqërisë civile të vendeve

pritëse me ato të origjinës së emigrantëve, në mënyrë që t'i shërbehet mirëkuptimit të popujve. Qeveria e Republikës së Shqipërisë ndjehet e përgjegjshme të punojë, në nivel bilateral, me qeveritë e vendeve pritëse të emigrantëve shqiptarë, me qëllimin që këta emigrantë të shndërrohen seriozisht në ura afrimi mes popujve. Kjo përgjegjësi duhet të reflektohet edhe në trajtimin e të huajve që qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë, kryesisht me motive punësimi, bazuar mbi parimin e reciprocitetit, si edhe mbi bazën e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Asocim-Stabilizimit.

3.2 Qeveria e Republikës së Shqipërisë e sheh të domosdoshme përpilimin e strategjive të koordinuara në nivel kombëtar rajonale e më gjerë, për të parandaluar trajtimin çnjerëzor dhe diskriminues të emigrantëve. Ngritja e mureve ndërmjet kombeve nuk përbën kurrfarë zgjidhje. Në këtë kontekst, përjasjet më premtuese rezultojnë të jenë hapat e bashkëpunimit, të ndërmarrë nga vendet e origjinës, të tranzitit dhe të destinacionit, në mënyrë që të përballohet dukuria e emigracionit masiv. Strategjia Kombëtare për Informim/Komunikimi dhe Plani Kombëtar i Veprimit, miratuar nga Komiteti Ndërministror i Migrimin përbëjnë një bazë të shëndoshë për përpilimin e programeve dhe projekteve që ndihmojnë për njohjen e të drejtave të emigrantëve dhe trajtimin e duhur, nga ana e institucioneve dhe shoqërive civile të vendeve pritëse.

3.3 Sfidat e emigracionit: Integrimi i bashkësive të emigrantëve mund të sjellë një numër sfidash, përfshirë vështirësitë për akses në arsim, në sistemin e shërbimeve shoqërore, si dhe për tejkalimin e kufizimeve për strehim, punësim, marrjen e mundshme të shtetësisë së vendit pritës, pa anashkaluar përballjen me eksperiencat e racizmit. Në këtë sens, është e nevojshme të ndërmerren hapat e duhur për hartimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve me vendet fqinje, për të drejtat e emigrantëve në fushën e të drejtave që rrjedhin nga qëndrimi dhe punësimi i rregullt, përfshirë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

3.4 Lufta kundër diskriminimit: Në kuadrin e Bashkimit Europian, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të përkthyer zhvillimin dhe zbatimin të politikave lehtësuese për pjesëmarrjen e bashkësive të emigrantëve në shoqëritë pritëse, përmes adoptimit të Strategjisë Europiane të Punësimit, që synon të mënjanojë pengesat e punësimit për punëtorët emigrantë dhe minoritetet etnike, si dhe përmes ngritjes së Qendrës Europiane të Monitorimit të Ksenofobisë dhe Racizmit (EUMC). Këto eksperiencat duhet të shërbejnë si bazë për të drejtat e emigrantëve tanë në vendet e Bashkimit Europian, por njëkohësisht edhe si hartë rruge, në kontekstin e integritimit europian të Shqipërisë. Qeveria mund të rrisë bashkëpunimin me vendet pritëse të emigrantëve për zgjerimin e spektrit të të drejtave ekonomike, sociale dhe politike të emigrantëve shqiptarë, në respekt të Kartës Sociale Europiane (të Rishikuar), nënshkruar e ratifikuar nga qeveria e Shqipërisë.

3.5. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, duke inkurajuar programet dhe projektet ekzistuese në fushën e nxitjes së punësimit për kategoritë që ndeshin vështirësi në tregun e punës, duhet të vijojë me intensitet bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare të specializuara, në këtë drejtim, siç janë Organizata Ndërkombëtare e Punës, (ILO), Organizata Ndërkombëtare për Migrimin, (IOM), UNDP, OSBE etj.

3.5. Mbështetja për një dialog gjithëpërfshirës, në të gjitha nivelet: Përcaktimi i strategjive koherente të integritimit kërkon zhvillimin e një dialogu të rregullt, ndërmjet përfaqësuesve të qeverive, bashkësive të emigrantëve, shoqërisë civile dhe punëdhënësve, në nivel vendor, kombëtar, rajonal e më gjerë. Strukturat institucionale që mbështesin dialogun, mbi bazë periodike, sigurojnë efikasitetin e këtyre përfaqësuesve, duke nxitur më shumë integrimin e emigrantëve. Nëpërmjet këtyre përpjekjeve bëhet e mundur arritja e një ekuilibri ndërmjet kërkesave për integrim dhe nevojës për ruajtjen e identitetit kulturor e fetar përkatës.

3.6. Lidërshtetja: Lidërshtetja politik, ai fetar dhe shoqëria civile në Shqipëri, duhet të ndihmojnë, duke krijuar klimën e përshtatshme, ku të brendashkruhen debatet mbi emigracionin, në mbrojtje të të drejtave të emigrantëve, duke evidentuar kontributet e tyre në jetën dhe begatinë e bashkësive pritëse.

3.7. Qeveria duhet të nxisë me iniciativa ligjore, financiare, bankare dhe fiskale kthimin vullnetar të emigrantëve të suksesshëm dhe investimin në Shqipëri të kapitaleve financiare, humane dhe sociale të emigracionit, si faktorë dhe burime të rëndësishme të zhvillimit të vendit.

3.8 Në përshtatje me objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit të synohet zhdukja e varfërisë, si një ndër masat me efektive për uljen e ritmeve të emigracionit dhe krijimin e kushteve të punësimit të atyre emigrantëve që duan të kthehen në atdhe.

4. MEDIA

Ndikimi i medias për formësimin e pikëpamjeve: Media, në të gjitha format e veta, ka potencialin për të shërbyer si një urë ndërmjet kulturave dhe shoqërive.

Në këtë kontekst, merr rëndësi mbështetja ndaj mekanizmit të medias të përgjigjes së shpejtë, (Rapid Response Media Mechanism) që AoC e ka lançuar gjatë Forumit të Madridit, me synimin për të krijuar një sit online të ekspertëve, të cilëve media mund t'u drejtohet, për efekt konsultimi, gjatë periudhave të krizave.

Interneti dhe revolucioni dixhital: Interneti dhe zhvillimi i medias dixhitale kanë çelur hapësira të reja për konsumatorët e medias, në përgjithësi, duke siguruar mundësitë për rritjen e komunikimit ndërnjerëzor. Interneti mund të shërbejë si një rrjet ideal për ndërveprimin shoqëror dhe si një forum unik për shkëmbimin e ideve dhe të informacionit. Nga kjo pikëpamje, interneti përbën një mekanizëm efikas për të riparuar ndarjet kulturore e fetare, duke vendosur në lidhje aktivistët dhe partnerët e ndryshëm, të aftë për të nxitur dialogun dhe mirëkuptimin.

IV – ÇËSHTJE ORGANIZATIVE - STRUKTURA - KOMITETI KORDINUES KOMBËTAR

1. Nën kujdesin e Kryeministrit ngrihet komiteti kombëtar, i cili është autoriteti permanent që do të mbikëqyrë vënien në jetë të planit të zbatimit të AoC-së, si dhe të Strategjisë Kombëtare, të hartuar për këtë qëllim. Komiteti kryesohet nga zëvendëskryeministri.

2. Komiteti përfshin titullarët e ministrive ngarkuar posaçërisht në këtë strategji për zbatimin e saj, po ashtu drejtuesit më të lartë të institucioneve të tilla shtetërore si komiteti shtetëror për minoritetet, komiteti kulteve, përfaqësuesi i posaçëm i kryetarit të Gjykatës së Lartë, përfaqësuesi i posaçëm i Prokurorit të Përgjithshëm, kreu i Komunitetit Mysliman, kreu i Kishës Autoqefale Ortodokse, kreu i Kishës Katolike, i Komunitetit të Bektashinjve ose përfaqësuesit e tyre, si dhe nga shoqëria civile, Kryetari i Dhomës së Avokatëve, Kryetari i Komitetit të Helsinkit, Drejtori i Institutit Shqiptar të Medias, kryetari i forumit shqiptar për aleancë të qytetërimeve. Komiteti Kombëtar mbetet i hapur për t'u shtuar me anëtarë të rinj në të ardhmen nga shoqëria civile. Ky Komitet mblidhet jo më pak se dy herë në vit.

3. Komiteti Kombëtar raporton, sipas kërkesës, me shkrim ose me gojë, para Presidentit të Republikës, para Kryeministrit dhe informon lidhur me veprimtarinë e zhvilluar në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, në zbatim të planit të AoC në parlament para komisioneve të ndryshme apo edhe seancës plenare, në rast se i kërkohet një gjë e tillë. Në këto instanca të larta, në emër të Komitetit Kombëtar, raporton ose informon kryetari i këtij komiteti ose Ministri i Punëve të Jashtme, me porosi të kryetarit. Në mungesë të Ministrit të Punëve të Jashtme, kryetari i komitetit kombëtar mund të ngarkojë edhe përfaqësues të tjerë të raportojnë ose të informojnë.

4. Me zbatimin e kësaj strategjie ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Komiteti Shtetëror i Minoriteteve dhe Komiteti i Kulteve.

5. Ministria e Punëve të Jashtme detyrohet të raportojë përpara Komitetit Kombëtar jo më pak se një herë në vit mbi veprimtaritë ndërkombëtare zhvilluar në kuadër të Planit të Zbatimit të AoC dhe posaçërisht për rolin që ka luajtur Shqipëria në këto veprimtari.

6. Ministria e Punëve të Jashtme ngarkohet të mbajë të informuar në vazhdimësi përfaqësuesin e lartë të sekretarit të përgjithshëm të OKB-së për aleancën e qytetërimeve, si edhe dy bashkëkryetarët e AoC, kryeministrin spanjoll dhe kryeministrin turk mbi zbatimin në Shqipëri të strategjisë kombëtare. Për këtë qëllim, ministrinë e ngarkuara më lart për zbatimin e kësaj strategjie

detyrohen ta mbajnë rregullisht të informuar Ministrinë e Punëve të Jashtme mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe detyrat që dalin prej saj në të ardhmen, sipas sektorëve përkatës të përmendur më lart.

PROJEKTE

- Në përgjigje të planit të implementimit për dy vjetët e ardhshme të AoC-së, Ministria e Arsimit do të mbështesë financiarisht një organizatë joqeveritare shqiptare, që punon në fushën e aleancës mes qytetërimeve për të realizuar përkthimin dhe përhapjen sa më të gjerë, veçanërisht të rinia, të historisë së njerëzimit, projekt i konfirmuar i UNESCO-s, si një instrument i vyer në duart e mbarë shoqërisë shqiptare për të njohur vlerat e trashëguara nga njerëzimi i sotëm përkitazi me nxitjen e respektit dhe të solidaritetit të ndërsjellë mes popujve dhe komuniteteve me identitete të ndryshme kulturore, etnike apo fetare.

- Arsimi gjithëpërfshirës dhe ndërkulturor: Ky objektivi duhet të synojë rritjen e frekuentimit të nxënësve në arsimin e detyruar, veçanërisht të disa kategorive më të prekshme dhe problematike, siç janë femrat dhe fëmijët rom. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta do t'iu krijojë atyre shanse reale për t'u integruar në tregun e punës.

- Programet e shkëmbimeve për profesorët e universiteteve dhe studentët pasuniversitarë, kanë ndikim vetëm pozitiv. Këto shkëmbime janë dëshmuar me shumë dobi për transferimin e dijeve shkencore, të cilat, në vetvete, përbëjnë një faktor kyç për nxitjen e zhvillimit të një vendi ende në tranzicion demokratik si Shqipëria. Qeveria shqiptare do t'i kërkojë Komisionit Europian shtimin e këtyre programeve në vitet e ardhshme, si kontribut substancial që Bashkimi Europian do t'i japë shoqërisë shqiptare për transformimin e mentalitetit.

- Organizimi i një Konference Ndërkombëtare me temë: "Sfidat dhe mundësitë e integritimit të Shqipërisë në BE."

- Organizimi dhe promovimi i seminareve dhe takimeve në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me demokracinë, të drejtat e njeriut dhe roli i fesë në një shoqëri moderne.

- Rishikim i të gjitha programeve të sistemit arsimor të vendit, përfshirë shkollat private fetare që ekzistojnë në Shqipëri, në mënyrë që lëndët e mësuara, t'u përçojnë nxënësve mirëkuptimin dhe respektin ndaj besimeve dhe praktikave të ndryshme fetare e ndaj kulturave të tjera të botës.

- Mungesa e aksesit në internet, veçanërisht në zonat rurale, pengon përshtatjen me konceptet e ndërkulturalitetit. Pa një përhapje të gjerë të aksesit në internet, veçanërisht në sistemin shkollor, popullsitë e këtyre zonave rurale do ta kenë të pamundur të marrin plotësisht pjesë në procesin e aksesit ndaj informacionit dhe për pasojë, mbeten ku më shumë e ku më pak jashtë efekteve ndërvepruese të një bote shumëkulturore.

Objektivi i qeverisë shqiptare për ta shtrirë shërbimin e internetit në të gjithë shkollat e mesme të vendit brenda gjysmës së parë 2009.

- Shkëmbime programesh dhe veprimtarish të përbashkëta rinore në kuadrin ballkanik. Në këtë kontekst, në rajonin tonë paraqesin interes programet që nxisin shkëmbime ndërmjet të rinjve që vijnë nga hapësira të ndryshme kulturore apo etnike. Në këtë drejtim, Ministria e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve do të hartojë programe të larmishme.

- Parashikohet ngritja e një grupi pune ndërministror, për hartimin e një strategjie afatshkurtër dhe afatmesme mbi punësimin e të rinjve, lehtësirat fiskale dhe mbështetjet e formave të tjera nga ana e qeverisë për ndërmarrjet që punësojnë të rinj, si edhe për vetë të rinjtë që guxojnë krijimin e ndërmarrjeve të tyre.

Problem të veçantë përbën një pjesë e madhe e të rinjve përfaqësues të komunitetit rom, të cilët kanë qenë të papunë për një periudhë disavjeçare, dhe midis tyre pjesa më e madhe nuk janë në gjendje që të gjejnë punë edhe në ditët e sotme.

- Nxitja e zhvillimit të marrëdhënieve të mira ndërfetare, evidentimi dhe ndjekja e rasteve që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të besimit fetar, si dhe atyre që nxisin akte terroriste, dhunë dhe vetëflim, nëpërmjet idesë së besimit fetar.

- Prodhim i broshurave dhe filmave dokumentarë për të promovuar vlerat e trajtuara nga aleanca e qytetërimeve.

- Aktualisht vendi ka fluksin më të lartë të emigrimit në Europë, rreth 25% e popullsisë së përgjithshme ose rreth 35% e popullsisë aktive.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë ndjehet e përgjegjshme të punojë në nivel bilateral me qeveritë e vendeve pritëse të emigrantëve shqiptarë, me qëllimin që këta emigrantë të shndërrohen seriozisht në ura afrimi mes popujve.

Zhvillimin e një dialogu të rregullt, ndërmjet përfaqësuesve të qeverive, bashkësive të emigrantëve, shoqërisë civile dhe punëdhënësve, në nivel vendor, kombëtar, rajonal e më gjerë.

- Mbështetja ndaj mekanizmit të medias të përgjigjes së shpejtë me synimin për të krijuar një sit *online* të ekspertëve, të cilëve media mund t'u drejtohet, për efekt konsultimi, gjatë periudhave të krizave.

VENDIM

Nr.131, datë 21.1.2009

PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË KRITEREVE PËR PËRFITIMIN, NË FORMË GRANTI, TË ASISTENCËS FINANCIARE PËR ZONAT E THELLA MALORE DHE ME POPULLSI TË RRALLË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 26 të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitojnë asistencë financiare, në formë granti, ata individë, persona fizikë a juridikë, që kërkojnë të zhvillojnë sipërmarrje turistike në zonat e thella malore dhe me popullsi të rrallë, për përmirësimin e strukturës ekzistuese.

2. Asistenca financiare jepet nga Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Turizmit, nëpërmjet programeve të asistencës, për të mbështetur financiarisht projektet turistike, për përmirësimin e strukturave ekzistuese turistike në zonat e thella malore, me kusht që të sigurojnë:

- planimetrinë e strukturës ekzistuese;
- planimetrinë e strukturës, që do të përmirësohet;
- deklaratën për mosndryshimin e destinacionit të veprimtarisë së strukturës, që do të përmirësohet, deri në pesë vjet;

- deklaratën bankare, se subjekti mbështet pjesën tjetër, që nuk mbulohet nga programi i asistencës financiare;

- dokumentin e organit tatimor, i cili vërteton regjistrimin e përfituesit në këtë organ;

- deklaratën për hapjen, të paktën, e një vendi të ri pune.

3. Masa e mbështetjes me programe të asistencës financiare për këto projekte turistike varet nga rëndësia e investimit dhe hapja e vendeve të punës. Në zonat e thella malore dhe me popullsi të rrallë programet e asistencës financiare mund të mbulojnë deri në 50 për qind të kostove të pranueshme të investimit ose të hapjes së vendeve të reja të punës. Vlera maksimale financiare e asistencës nuk duhet të kalojë masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

4. Subjektet, që kërkojnë të përfitojnë një program asistence, aplikojnë pranë Agjencisë Kombëtare të Turizmit (AKT), e cila, pasi mbikëqyr përmbushjen e kushteve dhe të kriterëve, i paraqet, për miratim, komisionit ndërministror listën me emrat e subjekteve.

AKT-ja për aplikimet e miratuara, përgatit programet e asistencës, të cilat ia paraqet për miratim Komisionit të Ndhmës Shtetërore, në bazë të dispozitave të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”.

Komisioni ndërministror përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

5. Mënyra e funksionimit dhe e organizimit të komisionit ndërministror përcaktohet me urdhër të kryeministrit.

6. Pas miratimit të dhënies së programit të asistencës, drejtori i AKT-së nënshkruan kontratën/marrëveshjen përkatëse me subjektet, në përputhje me vlerën financiare të programit të asistencës.

7. Në rast se subjekti përfitues i asistencës financiare nuk plotëson detyrimet, sipas programit të miratuar, asistencë financiare quhet e keqpërdorur dhe ndaj subjektit veprohet në përputhje me nenin 27 të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”, të ndryshuar, dhe me dispozitat e kreut III, të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”.

8. Për dhënien e raportimit e çdo skeme të asistencës financiare dhe të çdo ndihme individuale, në bazë të këtij vendimi, ndiqen të gjitha rregullat dhe procedurat e përcaktuara në ligjin nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, dhe në aktet nënligjore, dalë në zbatim të tij.

9. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.143, datë 11.2.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.338, DATË 19.3.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E MODELIT TË TREGUT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neni 53 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 9 të modelit të tregut të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr.338, datë 19.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, të ndryshuar, shtohet pika 10, me këtë përmbajtje:

“10. Dispozita tranzitore

Sa kohë që OSSH, sh.a.-ja, është shoqëri shtetërore, energjia elektrike, që prodhohet nga KESH, sha-ja, mbi kërkesën e furnizuesit publik me pakicë, i shitet OSSH, sh.a.-së, për mbulimin e humbjeve, në sasinë që kërkohet prej saj. Çmimi i shitjes do të jetë çmimi i miratuar nga ERE, për furnizuesin publik me pakicë, për vitin, në të cilin realizohet shitja.”.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe KESH, sh.a.-ja, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.153, datë 11.2.2009

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT TË DISA
MJEDISEVE NË NDËRTESEN (GODINËN) E INIMA-S

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Dhënien në përdorim Qendrës Kombëtare të Licencimit të disa mjediseve, në katin e dytë, në ndërtesën e ish-INIMA-s, në administrim të Këshillit të Ministrave, sipas vendndodhjes së përcaktuar në planimetrinë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr.614, datë 12.9.2007 “Për dhënien në përdorim të Agjencisë së Prokurimeve Publike të disa mjediseve të ndërtesës (godinës) së ish-INIMA-s”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.173, datë 19.2.2009

**PËR MIRATIMIN E FONDIT LIMIT TË SHPENZIMEVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
RADIO DHE TELEVISIONIT, PËR VITIN 2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin, publik e privat, në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2009, në shumën 75 500 000 (shtatëdhjetë e pesë milionë e pesëqind mijë) lekë, zëri “Shpenzime korrente”, dhe 55 000 0000 (pesëdhjetë e pesë milionë) lekë, zëri “Investime” .
2. Ngarkohet Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.191, datë 19.2.2009

**PËR DHËNIEN E NJË FONDI FINANCIAR KOMUNËS HAJMEL, TË QARKUT TË
SHKODRËS, PËR TË NDIHMUAR FAMILJET E DËMTUARA, PËR SHKAK TË
PËRMBYTJES NGA LUMI GJADËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 31 e 32/a të ligjit nr.8756, datë 26.2.2001 “Për emergjencat civile”, e të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komunës Hajmel, të qarkut të Shkodrës, në buxhetin e vitit 2009, t’i shtohet fondi 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për të ndihmuar familjet e dëmtuara, për shkak të përmytjes nga lumi Gjadër.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Fondi i dhënë sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përdoret nga familjet, për të riparuar dëmtimet e shkaktuara nga përmytja.
4. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, prefekti i qarkut të Shkodrës dhe komuna Hajmel për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-eksponitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 5.8.2010

Doli nga shtypi më 7.8.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 32 lekë